



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 17

Prishtinë, më 22.7.2013, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

P R O C E S V E R B A L
I M B L E D H J E S S Ë K O M I S I O N I T P Ë R I N T E G R I M E E V R O P I A N E

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavleviq, Blerta Deliu – Kodra, Ismet Beqiri, Blerim Shala, Suzan Novoberdali dhe Albert Kinolli.

Munguan: Fatmir Limaj, Vjosa Osmani dhe Glauk Konjufca.

Stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri, Adelina Demolli dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi: Lutfi Haziri, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të dt. 05.7.2013 dhe 11.7.2013;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-174 për planifikim hapësinor, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L- 137 për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Të ndryshme.

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

Njoftoi anëtarët e Komisionit se është bërë një ndërrim nga radhët e Vetëvendosjes, ku në vend të deputetes Alma Lama, tani anëtar i Komisionit është deputeti Glauk Konjufca.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të dt. 05.7.2013 dhe 11.7.2013

Procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit, të datës 05.07.2013 dhe 11.07.2013, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-174 për planifikim hapësinor, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesi, ftoi deputeten Blerta Deliu-Kodra, referuese të projektligjit, që ta paraqesë raportin për këtë projektligj.

Blerta Deliu-Kodra- Tha se Projektligji për planifikim hapësinor ka për qëllim të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për territorin e Kosovës.

Pas shqyrtimit dhe verifikimit, konsiderojmë se Projektligji për planifikim hapësinor nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit primar dhe sekondar të Bashkimit Evropian, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-174 për planifikim hapësinor, me amendamentet e Komisionit Funksional, është në harmoni me Acquis të BE- së.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L- 137 për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesi, ftoi deputeten Alma Lama, hartuese e këtij projektligji, që të arsyetojë këtë projektligj.

Alma Lama- Tha se sa i përket përputhjes me legjislacionin e BE-së, ky projektligj që mbulon fushën e mbrojtjes së burimeve të gazetarisë, nuk rregullohet me legjislacion të BE-së. Por, lidhur me këtë, Këshilli i Evropës ka Konventën për të Drejtat e Njeriut, e cila e rregullon çështjen e lirisë së mediave dhe ky projektligj është në përputhje të plotë me këtë konventë dhe me rekomandimet më të fundit të Këshillit të Evropës, në lidhje me mbrojtjen e burimeve të gazetarisë. Projektligji mbron burimet e gazetarisë dhe nuk ka të bëjë aspak me gazetarët ose mediat të cilat shpifin.

Xhavit Haliti – Nuk jam dakord me mënyrën se si i procedojmë ligjet, sepse kemi një mori ligjesh që po na kthehen në rishqyrtim. Çfarë po zgjedhim ne me një ligj të tillë si Kosovë, pasi asnjë shtet evropian nuk e ka në mënyrë të njëjtë të rregulluar këtë fushë. Kjo varet shumë nga ndërgjegjja e qytetarëve dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve, dhe mbi të gjitha, nga përcaktimi i gazetarit për të qenë gazetar apo shantazhues, gazetar apo shpifës. Në mes të kësaj kemi mjaft argumente të cilat na bëjnë që një pjesë e madhe e gazetarëve të mos jenë të besueshëm për shkrimet e tyre që i bëjnë në Kosovë. Në emër të demokracisë, ose lirisë që e kanë të mbrojtur me ligj, të krijojnë shqetësime tek familjarët e qytetarët e pse jo edhe tek shantazhimi i drejtpërdrejtë i institucioneve në momente të caktuara. Jam për ta miratuar këtë projektligj, por mendoj që komuniteti i gazetarëve duhet të punojë shumë me vetveten, që informatat të mos jenë të fabrikuara, të mos jenë informata të paguara për të dezinformuar. Do të dëshiroja që gazetaria në Kosovë, të jetë përafërsisht afër ndonjë gazetarie në Evropë. Mendoj se Kosova është në një situatë të përpjekjeve për t'u bërë një shtet demokratik, shtet stabil, shtet i cili mbron së pari të drejtat e njeriut, e pastaj të gazetarëve, e të gjithë atyre të cilët janë çështje nëpër medime të ndryshme. Nëse opinionistët e ndryshëm akuzojnë publikisht dikë pa një bazë të argumentuar dhe nuk i pyesin të akuzuarit se a qëndron kjo, atëherë është një problem me të cilin shoqëria kosovare do të ketë problem në të ardhmen. Jam për atë që medimet, veçanërisht pronarët edhe ata realë, edhe ata që qëndrojnë prapa tyre, ta kenë parasysh që investimin ta bëjnë për të bërë media të mira në Kosovë dhe jo për të krijuar kaos në informim dhe për t'i bërë mediat të pabesueshme.

Alma Lama- Ndaj të njëjtin mendim me deputetin Haliti, edhe vetë kam qenë shpesh pjesë e raportimeve joprofesionale dhe shpifjeve. Ky projektligj është fushë tjetër që kontribuon jashtëzakonisht shumë në

rritjen e transparencës dhe është një mbrojtje që i ofrohet punës së gazetarëve e cila është bërë duke u bazuar në praktikat më të mira të shteteve evropiane. Synimi im ka qenë që edhe gazetaria të jetë e nivelit të ngjashëm me atë të shteteve të Evropës. Çështja e profesionalizmit të gazetarëve dhe mediave mbetet pjesë edhe e ndërgjegjes së tyre.

Kryesuesi, ftoi deputeten Suzan Novoberdali, referuese e projektligjit, që ta paraqesë raportin për këtë projektligj.

Suzan Novoberdali - Tha se Projektligji për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë ka për qëllim mbrojtjen e së drejtës së gazetarisë, për të ruajtur burimin e informacionit dhe garantimin e lirisë së shprehjes. Pas shqyrtimit dhe verifikimit, konsiderojmë se Projektligji për planifikim hapësinor, nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit primar dhe sekondar të Bashkimit Evropian, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 04/L- 137 për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, me amendamentet e Komisionit Funksional, është në harmoni me Acquis të BE- së.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitit 2013, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesi, referues i projektligjit, paraqiti raportin për këtë projektligj. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitit 2013, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, mund të kalojë për miratim, për shkak se kjo fushë rregullohet me legjislacion nacional.

Ismet Beqiri- Konsideroi se nuk ka ndonjë ndryshim nga leximi i parë dhe nuk kam arsye që të votoj pro këtij projektligji, andaj vota ime do të jetë kundër.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni, me gjashtë vota për dhe dy kundër, nxori këtë

Përfundim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, me amendamentet e Komisionit Funksional, rregullohet me legjislacion nacional të shteteve anëtare.

6. Të ndryshme.

a) Vizita e ish- zëvendëskryenegociatores së Kroacisë

Kryesuesi- Njoftoi anëtarët e Komisionit se më 25.07.2013 është planifikuar takimi me ish- zëvendëskryenegociatoren e Kroacisë, z.Tamara Obradoviç. Më pastaj, në shtator, planifikohet vizita e Komisionit në Kroaci.

b) Vizita e Ministrit të Punëve të Jashtme të Lituanisë

Kryesuesi- Po ashtu, njoftoi anëtarët e Komisionit se më 26.07.2013, është planifikuar takimi me ministrin e Punëve të Jashtme të Lituanisë, z. Linas Linkevičius.

c) Vizita e delegacionit danez

Kryesuesi- Njoftoi se më 25 dhe 26 shtator për vizitë do të vijë Komisioni danez për çështje evropiane. Përgatitjet rreth vizitës së tyre rajonale tanimë kanë filluar. Komisioni ynë do të jetë nikoqir.

d) Formimi i panelit për përzgjedhjen e kandidatit për mbështetje të Komisionit

Kryesuesi- Njoftoi se me mbështetjen e CDF-it, do të angazhohet një këshilltar për mbështetje të Komisionit për periudhën gjashtëmujore.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Formohet paneli prej deputetëve: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviq dhe Suzan Novoberdali, për përzgjedhjen e këshilltarit për mbështetje të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Lutfi HAZIRI